



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 18.5.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku-nënkryetar i parë, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha-anëtarë.

Munguan: Bojan Mitiq, Nuredin Ibishi dhe Qerim Bajrami.

Pjesëmarrëse e anëtarëve të Komisioneve të tjera të Kuvendit- Aidë Dërguti-Nënkryetare e Kuvendit të Kosovës dhe anëtare e Komisionit për Mbikëqyrjen AKI-së

Përfaqësuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme: Skender Hyseni- Ministër i MPB, Shpend Maxhuni- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shqipe Mjekiçi-Këshilltare e ministrit dhe Shkodran Manaj-Këshilltar i ministrit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hajdari, EULEX; Ardiana Gashi-OSBE, Drita Perezizi-ICITAP, Leonora Brkani-ICITAP, Përparim Kryeziu-QKSS dhe Arbanë Pireva, praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Komisionit të mbajtura më 17.04.2015, 22.04.2015 dhe 05.05.2015;
3. Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- Filloi takimin duke propozuar që fillimisht të vazhdojmë me debatin me ministrin e Punëve të Brendshme, dhe më pas të bëhet shqyrtimi i pikave të tjera të paraparë në rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, ku pika e tretë kalon si pikë e parë e rendit të ditës.

Kryetari- Me dakordim me ministrin mbledhja do të jetë e hapur për media. Më tutje theksoi se ky takim është thirrur për ngjarjet që ndodhën në Kumanovë, për një paqartësi në opinionin publik të pozicionit të Kosovës, prandaj për këtë qëllim edhe më kërkesën e anëtarëve të Komisionit është ftuar në raportim ministri i Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, për të raportuar për gjendjen dhe për ato çështje që nuk pengojnë hetimin por që mund të dihen nga opinioni publik. Fjalën ia dha ministrit Hyseni.

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Fillimisht theksoi se për të diskutuar për këtë çështje ka qenë i gatshëm edhe në seancën e kaluar të Kuvendit por që ishte vendim i Kuvendit që mos të diskutohej për këtë çështje. Pastaj theksoi se e ka mirëpritur ftesën e Komisionit për të diskutuar për këtë çështje dhe se prania e mediave në takim do të ishte mirë të qëndronin deri në përfundim të takimit, për të qartësuar keqinterpretimet që kanë ndodhur këto ditë, sa i përket rolit që ka pasur Ministria dhe ministri i Punëve të Brendshme në këtë çështje.

Më tutje theksoi që ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, nuk kanë pranuar asnjë raport nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, i cili është publikuar në media. Lidhur me këtë ka pasur spekulime se nga ana e ministrisë nuk është ndërmarrë për të parandaluar rastet që kanë ndodhur. Në vazhdim të fjalës së tij tha se më 21 prill 2015 ka ndodhur në Gushnicë ajo çfarë ka ndodhur, ndërsa më 9 dhe 10 maj kanë ndodhur ngjarja dhe incidenti tragjik ku kanë humbur jetën një numër i qytetarëve, dhe sipas raporteve të deritanishme, një numër i qytetarëve të Kosovës.

Për këtë arsye tha se insiston që institucionet e Maqedonisë të lejojnë një hetim ndërkombëtar lidhur me ngjarjet në Kumanovë. Më 11 maj, theksoi se është kontaktuar nga një medium dhe pyetja që i është bërë ka qenë: A keni informacion çfarë po ndodh në Kumanovë? Përgjigjja ka qenë, që kemi informacion aq sa kemi, por asnjëherë nuk kam thanë që kemi pasur informacion se çfarë do të ndodhë. Kjo qëllimisht është interpretuar në një mënyrë tjetër pa asnjë bazë.

Prandaj, theksoi se Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka pasur asnjë informacion që mund të ndodhë ajo çfarë ka ndodhur, ndërkaq nga data 21 prilli 2015, MPB-ja ka bërë të gjitha veprimet e lejueshme me ligj në territorin Republikës së Kosovës që të sigurojë kufirin, të ndërmarrë veprime operative përgjatë gjithë vijës kufitare në atë zonë, pasi ne kemi përgjegjësi vetëm në kuadër të territorit të Kosovës dhe jo atë të Maqedonisë. Gjithashtu në kuadër të shtimit të aktiviteteve i është kërkuar sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së MPB-së, që të kontaktojë zyrat për menaxhimin e emergjencave në të gjitha komunat përgjatë kufirit me Maqedoninë, në mënyrë që të jemi të gatshëm për fluksin e mundshëm të qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Maqedoni. Ka qenë një familje prej tetë anëtarëve që ka kaluar kufirin ilegalisht, ndërsa të tjerët që janë afërsisht treqind persona, kanë kaluar kufirin në mënyrë zyrtare, dhe arsyetimi i tyre ka qenë frika në eskalimin e situatës.

Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar për zbatimin e ligjit në kuadër të Policisë së Kosovës, ka bërë përpjekje për marrjen e informatave të sakta nga autoritetet e Maqedonisë, lidhur me atë se çfarë po ndodh me qytetarët tanë të përfshirë në atë incident, gjithashtu kemi pasur kontakte të vazhdueshme me Ambasadorin e Kosovës në Maqedoni, por nga autoritete maqedonase informacionet ka qenë të mjegullta. Por vlerësoi që situata e krijuara atje nuk do të importohen në vendin tonë dhe se për vlerësimin e kësaj situata Këshilli i Evropës sot ka takimin dhe do të dalë me rekomandime. Si ministri do të kërkojmë që çdo gjë që është në juridiksionin e MPB-së dhe PK-së të ofrojmë sqarime dhe nuk do të lejojmë që konfliktet të sponsorizuar nga dikush tjetër të barten në institucionet e Kosovës.

Kryetari- Përveç kësaj theksoi se do të ishte mirë të dinim, se sa janë të arrestuar, sa janë të vrarë, pse janë bastisur familjet të cilat janë të pa informuara nëse kanë familjarë të vrarë?

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Theksoi se urdhër për bastisje ka dhënë prokurori dhe theksoi se as si ministër që është nuk e ka ditur që Prokurori jep urdhër për bastisjen e kujt do qoftë. Adresimi ndaj tij për këtë çështje nuk është adekuat, pasi është Ministria e Punëve të Jashtme ajo që komunikon me një shtet në rrafshin ndërkombëtar. Për këtë çështje mund t'iu drejtoheni prokurorisë që të jap sqarime, por jo Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës.

Shpend Maxhuni, drejtor i Përgjithshëm i Policisë- Sa i përket çështje së njoftimit të familjarëve të personave të vrarë, theksoi se si Polici e Kosovës kanë qenë në situatë të pa volitshme në raport me marrjen e informacioneve nga autoritete maqedonase për gjendjen në përgjithësi. Informacionet që kemi pranuar kanë qenë lidhur me verifikimin e identitetit të personave dhe kjo ka ardhur pas kërkesave tona.

Sa i përket njoftimit të familjarëve, fokusimi ka qenë në aspektin profesional, pasi nuk mund të konfirmojmë vdekjen pa certifikatën e vdekjes e cila duhet të procedohet përmes kanaleve diplomatike. Nga verifikimi i informacioneve, rezultojnë nëntë kosovarë të vrarë dhe njëzet e një të arrestuar dhe që janë nën masat e autoriteteve maqedonase. Ndërsa sa i përket kontrollit të bërë nga ana e Policisë së Kosovës, pa dashur të fajësojmë prokurorinë, është kompetencë *ex officio* edhe e Prokurorisë që të ndërmarrë masa dhe veprime, dhe veprimi operativ hetimor i policisë është bazuar në autorizimet e institucioneve kompetente.

Fadil Demaku- Çështja që diskutojmë sot është e ndjeshme dhe është njëra ndër takimet e nivelit më të lartë institucional dhe ku diskutohet në praninë e mediave. Konsideroj që të dyja palët duhet të ruajnë përgjegjësinë institucionale dhe të jenë korrekt edhe me opinionin. Kemi nevojë të kemi informacione dhe të dimë përgjegjësinë e palës tonë në incidentin ndodhur në Kumanovë, si dhe marrja e masave të nevojshme në mënyrë që të mos lejohet që konflikti që ka ndodhur atje të ndikojë në vendin tonë. Më tutje shtoi se vazhdon të mbrojtë qëndrimin që një shtet i kriminalizuar i njohur si i tillë për disa vite, të bëjë veprime që për interesa të mbajtjes së pushtetit dhe frikës nga opinioni i brendshëm, të përdorën njerëzit tanë si kartë për arritjen e qëllimeve të tyre. Prandaj konsideroj që në pyetjet dhe përgjigjeje të kemi sa më shumë informacione, që do të na shërbenin të kanalizojmë këtë situatë dhe të ndërmerren masa nga ana institucionale.

Rexhep Selimi- Lidhur me diskutimin z. Skender Hyseni, theksoi se kur iu referua se “ pyetjet duhet të shtrohen aty ku e kanë vendin”, theksoi se për këtë është dakord dhe një të tillë i ka bërë Kryeministrit në seancën plenare, pra janë bërë adresime dhe pyetje, por duhet të theksojmë që akoma nuk kemi një qëndrim zyrtar të Qeverisë lidhur me ngjarjet në Kumanovë. Konsideroi se do duhej të kishte qëndrim zyrtar për këtë çështje, po ashtu akoma nuk është dënuar dhuna ndaj shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni.

Më tutje shtroi këto pyetje për Ministrin Hyseni: A vlerësoni që Kryeministri ju ka informuar juve si ministri, nëse ai vetë ka qenë i informuar? Pasi rezulton të ketë qenë i informuar.

Më tutje theksoi që kur thuhet që nuk është në kompetencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të dijë paraprakisht lidhur me këtë çështje, mendoj që Policia duhet të ketë pasur një përshkrim të urdhërësës për bastisje. A mund të ndani me ne përshkrimin e kërkesës së prokurorisë për bastisje të këtyre familjeve?

Ndërsa sa i përket shifrave të cilat u dhanë se janë 9 persona të vrarë dhe 21 të arrestuar, në opinion nuk është dhënë nga asnjë institucion apo ministritë përkatëse listë të cilës do t'i referoheshim për numrin e të përfshirëve dhe të vrarëve. Pasi nga kjo që po kuptojmë duket që ministri i Punëve të Brendshme nuk është i informuar, ndërsa të tjerët nuk po duken që janë të pa informuar dhe nuk po flasin.

Qeveria e Kosovës vazhdon të na mbajë të pa informuar, mbase edhe në pajtim me qëndrimet e qeverive të tjera, gjë që nuk duhej të ishte kështu. Më tutje shtroi pyetjen e radhës. Bastisjet që kanë ndodhur në familjet a kanë qenë në pajtim me hetimet që bënë prokuroria e Maqedonisë kundër të arrestuarve? Prandaj kërkoi që nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, z. Maxhuni të jepet përshkrimi i urdhrit për bastisje të këtyre familjeve.

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Lidhur me qëndrimin e institucioneve të Kosovës, tha se qëndrimi duhet të bazohet mbi bazën e informacionit të plotë,

pasi pa informacion të plotë është politikisht dhe strategjikisht e vështirë dhe delikate të jepet një qëndrim. Më tutje theksoi se si ministër do të insistojë në një hetim të pa anshëm ndërkombëtar lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në Maqedoni. Ndërsa sa i përket pyetjes nëse ka qenë i informuar rreth asaj se çfarë mund të ndodhë në Maqedoni, theksoi se nuk ka qenë i informuar dhe se as nga ana e Kryeministrit nuk ka pasur informacion për këtë çështje.

Më tutje theksoi se ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, nuk kanë marrë raport nga ana e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, raport i cili ka dalë në media. Lidhur me bastisjen e familjeve që kanë pasur pjesëtarë të familjes të përfshirë në këto ngjarje, theksoi se është e vështirë të njoftosh për vdekjen e anëtarëve të saj, pa e pasur të konfirmuar.

Ndërsa sa i përket përkrahimit të kërkesës së Prokurorit për bastisje të familjeve, theksoi se si ministër nuk e dinë këtë çështje dhe këtë përkrahim, pasi do të ishte ndërhyrje.

Shpend Maxhuni- Theksoi se zhvillimi i hetimit nga prokuroria e shtetit të Kosovës nuk është paralel me hetimet që janë duke u zhvilluar në Maqedoni, dhe kjo është kuptuar nga takimi i fundit me prokurorinë që është realizuar. Ndërsa sa i përket përkrahimit të urdhërësës për bastisje, se çfarë përmban, theksoi se prokuroria e shtetit në bazë të kompetencave që ka sipas ligjit e ka autorizuar Policinë e Kosovës për ndërmarrjen e veprimeve që ka ndërmarrë policia. Gjithashtu shtoi e nuk mund të komentojë urdhëresat e prokurorisë.

Zafir Berisha- Për ngjarjet e ndodhura theksoi se është më tepër se e rëndë, pasi janë të implikuar edhe qytetarët e Kosovës. Më tutje theksoi e ajo çfarë dihet në opinion dhe nga ana e deputetëve, anëtarë të Komisionit për mbikëqyrjen e AKI-së, në muajin shkurt të këtij viti Komisioni është informuar që ka pasur lëvizje në këtë drejtim. Prandaj vlerësoj që si ministër i cili që përfaqëson Qeverinë, nuk keni pasur mendim të qartë lidhur me atë se çfarë ka ndodhur në Maqedoni, dhe kjo ka bërë që si deputetë dhe qytetarë të reagojnë.

Më tutje theksoi se me ngjarjet që kanë ndodhur në Kumanovë, përveç imazhit të Maqedonisë është dëmtuar edhe imazhi i Kosovës, dhe konsideroi se nga mos efikasiteti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka ardhur në situatën që investimet e bëra nga vendorët dhe ndërkombëtarët në Kosovë për integritet evropian, të kthehen në pikën zero.

Më tutje bëri pyetje drejtuar ministrit. Si ka mundësi që nga data 21 prill deri më 9 maj, Ministria e Punëve të Brendshme dhe organet e sigurisë së Kosovës të mos jenë në lëvizje dhe në përcjellje të situatës, ku në bazë të raportit që dhatë, ku janë 9 të vrarë dhe 21 të arrestuar, ku gjithsej janë tridhjetë qytetarë të Kosovës kanë lëvizur?

Cilët qytetarë kanë qenë në rastin e Kumanovës, dhe kush janë ata? Pasi ka pasur keqinterpretime dhe në raport me ta, pasi është thënë që disa nga ata kanë edhe dosje.

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Në përgjigjeje të pyetjeve të z. Berisha tha se nga data 21 prill Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme, kanë ndërmarrë të gjitha veprimet në territorin e Kosovës për parandalimin e situatës, ndërsa në territorin Maqedonisë nuk është e mundur të ndërhyjmë. Ndërsa sa i përket imazhit ndërkombëtar theksoi se ai dëmtohet në rast të mos reagimit kur janë prezent krizat, por vlerësoi që Republika e Kosovës ka bërë të gjitha veprimet që i ka pasur në kompetencë.

Shpend Maxhuni- Lidhur me angazhimin e Policisë së Kosovës, theksoi se kanë qenë në implementim, duke i marrë në konsideratë edhe obligimet që dalin nga koncepti i menaxhimit të integruar të kufirit me palën maqedonase. Pas incidentit në Gushnicë janë shtuar masat me qëllim të parandalimit të incidenteve të mundshme në brezin kufitar.

Me qëllim për t'u siguruar që Policia e Kosovës është në përmbushje të detyrave në mënyrë profesionale, është kërkuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë që të jenë prezent në terren, për të bërë vlerësimin e tyre, dhe për këtë kemi marrë notën më të lartë për angazhimin e Policisë së Kosovës në brezin kufitar. Krahës këtyre angazhimeve Policia e Kosovës i ka angazhuar njësitë strukturore relevante dhe përmes drejtorisë për bashkëpunim ndërkombëtar, kemi ofruar bashkëpunimin tonë. Bazuar në këto tha se vlerësimet aktuale dhe vlerësime e më hershme pas incidentit të Gushnicës, nuk tregojnë që ka pasur lëvizje përgjatë brezit të gjelbër të qytetarëve të Kosovës.

Zafir Berisha- Lidhur me përfshirjen e disa qytetarëve në ngjarjet e Maqedonisë, theksoi se është kuptuar që janë nga qytete të ndryshme të Kosovës dhe institucionet përgjegjëse të Kosovës nuk kanë qenë në dijeni. Për të mos ndodhur ato zhvillime është dashur të merren masa preventive. Për këtë arsye shtroi pyetjen nëse kanë qenë ose jo në dijeni për këto lëvizje?

Shpend Maxhuni- Theksoi se këtë çështje e elaboroi edhe më herët ku me plane konkrete, duke përfshirë edhe brezin e gjelbër që është konsideruar si pikë e ndjeshme për kalim të kufirit ilegal sepse informacionet e më hershme pas incidentit të Gushnicës, ka hyrë një numër i qytetarëve me armë brenda territorit të Kosovës, që doli se ky informacion të mos ishte i tillë. Dy ditë më vonë ishte marrë një informacion tjetër që në një zonë të caktuar konkretisht në fshatin Saraj kanë kaluar 50 qytetarë të Republikës së Kosovës, informacion që rezultojnë që nuk ishte i vërtetë, në këtë qasje, Policia e Kosovës ka qenë e angazhuar duke i përfshirë edhe aktivitetet e tjera brenda territorit të saj.

Ganimete Musliu- Shtroi pyetjen si vijon: Z. ministër a keni pasur ndonjë takim të përbashkët me Kryeministrin, ministrin e Punëve të Jashtme dhe me Presidenten? Nga momentit që e keni marr informacionin për situatën e krijuar në Kumanovë, nëse jeni takuar, sa herë jeni takuar dhe nëse nuk jeni takuar asnjëherë, cili ka qenë komunikimi juaj në këtë qarkorë? Duke pasur parasysh që bëhet fjalë për tridhjetë kosovarë, 9 prej tyre rezultojnë të vdekur dhe 21 të arrestuar.

Skender Hyseni- Tha se që nga fillet e para ka pasur shtatë takime me Presidenten dhe Kryeministrin, por ka pasur takime edhe në formate të ndryshme në analizim të situatës dhe këto takime kanë ndodhur çdo të dytën ditë, natyrisht ndonjë nga ato takime kanë shërbyer kryesisht në qëllim të analizimit të gjendjes dhe të informimit për veprimet që po i merr në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia për të parandaluar eskalimin e situatës në Kosovë. Është bërë përpjekje që ta përcjellim edhe kalimin e kufirit është e pamundshme që të ndalohet çdo kalim qoftë edhe ilegal, nuk ka kufi në botë sot përpos kufiri i Koresë së Veriut ndoshta që nuk mund të kalohet edhe ilegalisht, qytetarët e Kosovës në Shqipëri mund të dalin pa asnjë kontrollim dhe nga Republika e Shqipërisë mund të lëvizin ku të duan pa u regjistruar tek autoritetet e Kosovës.

Anton Quni- Z. Maxhuni, ne të gjithë kemi pasur mundësin në bazë të publikimeve të ndryshme të përcjellim situatën që ndodhi në Kumanovë, por jo të gjithë kemi vlerësime të njëjta natyrisht

që qytetarit mund të bëjë ndonjë vlerësim ndryshe, kurse ju jeni profesionist dhe më intereson një mendim dhe një vlerësim i juaji profesional në lidhje me angazhimin e forcave të policisë dhe forcave ushtarake në lidhje me taktikat e tyre, teknikat që kanë përdorur, intensitetin, përdorimi i forcës në proporcion me situatën, sjellja me banorët aq sa ju keni informata dhe një analogji, po të ndodhte një situatë e ngjashme në Kosovë. Nëse një formacion jo i paligjshëm të vepronte brenda territorit të Republikës së Kosovës, si do e menaxhonit ju një situatë të tillë?

Shpend Maxhuni- Tha se për shkak të mungesës së informacioneve dhe komunikimit të drejtpërdrejtë rreth natyrës dhe mënyrës të organizimit dhe implementimit të atij operacioni, nuk mund të japim vlerësim se si është përgatitur në çfarë forme, çfarë vlerësimi ka marrë për bazë, cili ka qenë niveli i rrezikut, modusin e përgatitjes së informacionit i cili është implementuar në Kumanovë. Ndërsa po që se hipotetizohet do të ndodhte kjo gjendje në Kosovë, unë besoj që Policia e Kosovës tash më ka dëshmuar nivelin e saj operacional dhe në çfarë do rrethane kur ne angazhohemi në shkallë të gjerë duke përfshirë edhe njësit më të specializuar brenda Policisë së Kosovës çdoherë veprimi është i bazuar mbi një vlerësim sa më real të një situatë e cila mund të paraqitet në teren, besoj që Policia e Kosovës do vazhdojë të jetë profesionale dhe në këtë rast dëshiroj që edhe opinioni edhe pse jam i bindur që tash më e ka të qartë sepse vlerësimet tregojnë nivelin profesional të Policisë së Kosovës përfshirë edhe analizat dhe vlerësimet ndërkombëtare se do të vazhdojmë të jemi afër qytetarëve duke ofruar siguri, për të ofruar një jetë të qetë përmes gjitha koncepteve dhe modeleve që Policia e Kosovës i ka të njohura dhe i aplikon për qytetarët e saj. Çdo situatë i ka sfidat e saja por më përgjegjësi mund ta them që Policia e Kosovës në gjitha operacionet, i ka implementuar çdoherë me sukses ne nuk kemi rast ku janë vrarë civilë, ku janë shkaktuar dëme materiale, ku ka pasur humbje të mëdha të forcave, ku janë shkaktuar dëme në pajisje, kur janë shkaktuar dëme në pronë qoftë publike apo private, dihet që ne e kemi pasur një operacion në 25 korrik 2011 ku ne kemi pasur të humbur një pjesëtar tonin, por veprimi ynë dhe niveli profesional ka mundësuar që të jemi të kujdesshëm që krahas realizimit të objektivit, të respektohen në maksimum të drejtat e njeriut. Ndërsa rrethanat e tjera kërkojnë veprime që parashihen me ligj japim këshilla që forca e ushtruar duhet të jetë proporcionale, prandaj vlerësoi se çfarëdo situatë që mund të paraqitet, Policia e Kosovës është e gatshme të përmbyll në mënyrë më të mirë të mundshme.

Aida Dërguti- Theksoi se menjëherë pas ngjarjeve në Kumanovë, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, më 12 maj 2015 ka ftuar në takim përfaqësuesit e AKI-së, dhe janë pyetur për raportin i cili është përfolur në media. AKI, para Komisionit ka konfirmuar që , më 23 shkurt 2015, raporti për këtë grup, i është dorëzuar Kryeministrit dhe Presidentes. Gjithashtu kanë theksuar që për ngjarjet e më hershme kanë qenë në dijeni, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Më tutej shtoi se nga Ministri i Punëve të Brendshme u tha që kjo ministri nuk ka pasur asnjë informacion, ndërsa më vonë tha që e ka lexuar. Me që Kryeministri e ka poseduar këtë raport nga data 23 shkurt të këtij viti. A ju është drejtuar juve si ministër që të ndërmerrni diçka në këtë drejtim, bazuar në indikatorët e këtij raporti?

Sa i përket përfshirjes së Kosovës në situatën e ndodhur në Maqedoni, vlerësoi se shteti i Kosovës është i përfshirë në dy aspekte, pasi janë një numër i qytetarëve që janë të përfshirë dhe se nga ana e Presidentit të Maqedonisë janë drejtuar letra për faktorin ndërkombëtar, ku është fajësuar Kosova për situatën në Kumanovë.

Çështje tjetër, se si është ndërmarrë ky veprim, ku vlerësoi se është ushtruar terror shtetëror si dhe deklaratat e udhëheqësve të institucioneve të Maqedonisë. Prandaj konsideroj që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, heziton të deklarohet për përmasat e këtij aksioni, të cilat kanë qenë jo profesionale. Prandaj vlerësoi se Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masa për qytetarët e Kosovës që janë në Maqedoni dhe të interesohen për kushtet në të cilët ndodhen të arrestuarve që tashmë janë në burgjet e Maqedonisë dhe të vrarët të sillen në Kosovë.

Fadil Demaku- Lidhur me deklaratën e znj. Aida Dërguti, bëri pyetjen nëse nga takimet e fundit me zyrtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. A ka qenë takimi i hapur për media apo i mbyllur? Informacionet që ndatë në këtë takim, është qëndrimi i juaj apo i Komisionit që jeni anëtare?

Aida Durguti- Theksoi se kjo është çështje informacioni dhe jo qëndrimi, ndërsa takimet e Komisionit kur janë prezent zyrtarët e AKI-së, kryesisht janë të mbyllura për media.

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Deklarimet e znj. Dërguti i konsideroi më shumë politike. Ndërsa sa i përket pyetjes nëse Kryeministri ka ndarë me ministrin raportin që u tha, theksoi se është në të drejtën ekskluzive të Kryeministrit, Presidentes dhe anëtarëve të Komisionit të AKI-së, se çfarë bënë publike. Prandaj theksoi se Ministria e Punëve të Brendshme, nuk ka pasur asnjë raport ose njoftim nga ato çfarë kanë dalë në opinion. Më tutje theksoi se nga takimet e përbashkëta që kanë pasur si ministri, me krerët e institucioneve, kanë dalë rekomandime të qarta se çfarë duhet të bëjë Kosova, dhe cilat duhet të jenë përgatitjet e Policisë së Kosovës dh organeve të rendit, në mënyrë që të mos lejohet që konflikti të zhvendosët në territorin e Kosovës, në mënyrë që Kosova të jetë faktor stabiliteti.

Rexhep Selimi- Lidhur me deklarin e ministrit z. Skender Hyseni, se çështja e ndarjes së informatës është në diskrecionin e Kryeministrit dhe Presidentes, shtoi se nëse besojmë që nga ana e AKI-së është bërë informimi i Kryeministrit dhe ka mbetur në diskrecionin e tij të ndaj informacionet në fushën e sigurisë. Bëri pyetjen: A vlerësoni që jeni anashkaluar nga Kryeministri nga temat të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me sigurinë?

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Rexhep Selimi, tha se nuk ndihet i anashkaluar, pasi nga takimet e rregullta me krerët e institucioneve është trajtuar çdo informacion i vlefshëm dhe relevant.

Daut Haradinaj- A mendoni z. ministër, që nga ana e Kryeministrit dhe Presidentes është neglizhuar informacioni dhe si rezultat i kësaj kemi një numër të madh të vrarëve?

Skender Hyseni-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Tha se është i sigurt që Kryeministri ka ndarë çdo informatë që duhet ndarë me Ministrin e Punëve të Brendshme.

Kryetari- Theksoi se qëllimi i këtij takimi, ka qenë marrja e informacioneve nga institucioni adekuat, ndërsa sa i përket raportit që u theksua nga znj. Dërguti, tha se si Komision nuk e posedojmë, pro mbase do të ishte mirë të kishim një takim të përbashkët me të dy komisioneve për këtë çështje.

Fadil Demku- Theksoi që për mbajtjen e këtij takimi, ka qenë iniciativë e tij që të mbahet takimi me ministrin, për sqarim të Komisionit dhe opinionit. Por vlerësoi që diskutimet që rrodhën nga fundi i këtij takimi lidhur me çështjen e raportit, nuk janë në fushëveprimin e Komisionit për Siguri. Nëse do të isha anëtar i Komisionit për AKI-së, në momentin e posedimit të informacionit, ka qenë e drejtë e Komisionit të mblidhet dhe të ftohet drejtori i AKI-së, ku prezent do të ishin edhe mediat në mënyrë që të njoftohet edhe opinioni, dhe nuk do të ishte e nevojshme që të bartet ky informacion.

Aida Dërguti- Theksoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, pas publikimit të raportit në media, i cili mund të ketë rrjedhë nga Zyra e Kryeministrit ose Presidentes, pasi është thënë që një kopje i është dorëzuar këtyre dy institucioneve, janë ftuar përfaqësuesit AKI-së. Nga ana e Komisionit nuk është parë raporti, por nga ana e AKI-së është konfirmuar që është dorëzuar ky raport, dhe për këtë kemi dashur të dimë nëse ka pasur informacion që do t'i ndihmonte Ministrisë.

Skender Hyseni, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme- Theksoi se si Ministër është i gatshëm për çdo konsultim dhe takim, pro jo që të biem pre e manipulimeve që i dëgjuam.

Kryetari- Pasi vlerësoi diskutimet e mbyllura, tha që takimi i sotëm ishte produktiv dhe në emër të Komisionit falënderoi për bashkëpunim ministrin dhe bashkëpunëtorët, ndërsa pikat e tjera të rendit të ditës barten për mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj